



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 208

Tiranë – E enjte, 30 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 181, datë 10.11.2017	Mbi miratimin e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”..... 10853
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 182, datë 10.11.2017	Mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”..... 10859
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 183, datë 10.11.2017	Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për një ndryshim në “Kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017..... 10867
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 184, datë 10.11.2017	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë MTC Energy sh.p.k., për transferimin e aseteve pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë..... 10869
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 185, datë 10.11.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Prima Energy sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 10869
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 10.11.2017	Mbi licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror..... 10870
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 188, datë 10.11.2017	Mbi licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror..... 10871

**VENDIM****Nr. 181, datë 10.11.2017****MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES
PËR KRITERET STANDARDE TË
CILËSISË SË SHËRBIMIT TË
FURNIZIMIT DHE PERFORMANCËS
SË SIGURISË SË RRJETIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 7, pika 1; 16 dhe 19, germa “h” dhe “j” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e “Drafttregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 95, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurave për shqyrtimin e “Drafttregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Me shkresën nr. 480 prot., datë 22.6.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, “Drafttregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në shkresën e saj me nr. 480/1 prot., i ERE-s, datë 4.7.2016, OST sh.a. ka paraqitur komentet e saj, lidhur me “Drafttregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të cilat janë reflektuar.

- Në shkresën e saj me nr. 524 prot. të EREs, datë 6.7.2016, “Shoqata e Mbrojtjes së Tregtarëve dhe Tregut të Shqipërisë”, lidhur me “Drafttregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ka paraqitur komentet e saj, të cilat janë reflektuar.

- Në shkresën me nr. 575 prot., datë 26.7.2016, ERE i ka kërkuar shoqërisë OSHEE sh.a. argumente dhe shpjegime përkatëse, lidhur me nivelet e lejuara të treguesve të cilësisë së shërbimit të paraqitur prej saj.

- Me shkresën nr. 575/1 prot., datë 4.8.2016, shoqëria OSHEE sh.a., ka dërguar argumentet dhe shpjegimet e saj lidhur me nivelet e lejuara të treguesve të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të propozuar prej saj.

- Me shkresën me nr. 716 prot. të ERE-s, datë 7.10.2016, kanë ardhur komente nga USAID-i mbi “Drafttregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit me energji elektrike”, duke propozuar vendosjen e një periudhe tranzitore lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve, në kuadër të ristrukturimit të sektorit të energjisë elektrike dhe implementimit të modelit të ri të tregut.

- Me shkresën nr. 775 prot., datë 3.11.2016, ERE i ka dërguar edhe një herë, për mendim, draftin e paraqitur nga USAID-i të gjitha palëve të interesuara dhe grupeve të interesit.

- Në vijim të shkresës me nr. 775 prot., datë 3.11.2016, kanë ardhur komente nga subjektet, si: MZHETTS, OST sh.a. dhe Shoqata e Konsumatorit Shqiptar, të cilat kanë paraqitur opinionet e tyre, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar rast pas rasti.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. dhe të gjitha palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**



RREGULLORE
PËR KRITERET STANDARDE TË
CILËSISË SË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT
DHE PERFORMANCËS SË SIGURISË SË
RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 7, pika 1, neni 19, germa “h” dhe “j” e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, neni 40; Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.

Neni 2

Objekti

2.1 Kjo rregullore specifikon treguesit dhe kërkesat e operimit dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe performancën në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sipas kërkesave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2.2 OSSH-ja ka detyrimin e shërbimit publik që të përmbushë kriteret standarde të cilësisë së furnizimit, të specifikuara nga Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes dhe kjo rregullore.

2.3 “Detyrimi i shërbimit publik” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, eficiencën e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

Neni 3

Përgjegjësitë dhe autoriteti i ERE-s

3.1 Bazuar në nenin 19, germa “h” dhe “j” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka përgjegjësitë dhe autoritetin e mëposhtëm në lidhje me çështjet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike:

a) Të publikojë kushtet për cilësinë e furnizimit të ofruar nga operatorët e sistemit;

b) Të nxisë përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike.

3.2 Bazuar në nenin 25, pika 2, germa “dh” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE duhet të përfshijë te raporti vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë brenda datës 31 mars të çdo viti, informacionin mbi të dhënat për cilësinë e furnizimit. Si pasojë, të licencuarit duhet të paraqesin informacion për cilësinë e furnizimit në ERE sipas nenit 6 dhe 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim dhe çdo term tjetër i parashikuar në këtë rregullore do ketë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”:

“Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose “OSSH” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

“Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike.

“Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

“Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

“Klient familjar” është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.

“Klientë jofamiljarë” janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.



Energjia e pafurnizuar (ENS) nënkupton treguesin e matjes së sasisë totale të energjisë elektrike (në MWh) që mund t'u ishte furnizuar klientëve, të cilëve iu është ndërprerë energjia elektrike, në rast se nuk do të kishte pasur ndërprerje. Ajo llogaritet si shumë e energjisë elektrike së pafurnizuar për çdo rast ndërprerjeje.

$$ENS = \sum_i E_i$$

ku E_i = është energjia e pafurnizuar për çdo rast (incident).

Cilësia e frekuencës (FQ) nënkupton një tregues të matjes së devijimit të frekuencës së sistemit mbi ose nën vlerën nominale prej 50 Hz.

Përqindja e klientëve aktualisht me matës, e cila përcaktohet duke pjesëtuar numrin e konsumatorëve të pajisur aktualisht me matës (lexuar ose nga distanca ose vizualisht) për një periudhë të caktuar kohe (muajore, katërmujore ose vjetore) me numrin e klientëve të lidhur në sistem. Përqindja e klientëve aktualisht pa matës i referohet klientëve të cilët mund të jenë me matës të dëmtuar apo jashtë kushtit teknik në momentin e deklarimit të të dhënave nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit nënkupton përqindjen e ankesave për devijimet e tensionit jashtë kufijve të specifikuar në kodin e rrjetit, që janë zgjidhur brenda afatit kohor të përcaktuar në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Ky tregues llogaritet në mënyrë të veçantë për zonat urbane dhe ato rurale.

Koha e nevojshme për t’iu përgjigjur ankesave që kanë lidhje me matjen nënkupton periudhën kohore (në ditë ose orë) ndërmjet kohës kur është bërë ankesa për matjen (matës i thyer, mungesë matësi, mospajtim me vlerat e konsumuara etj.) dhe kohës kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) i kthen përgjigje klientit për ankesën.

Koha e nevojshme për kërkesat për lidhjet e reja nënkupton kohën që i nevojitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të dhënë një përgjigje me shkrim për kërkesën për lidhje të re. Kjo kohë do të llogaritet bazuar në përcaktimet e

“Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”.

Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI), zakonisht i referohet kohëzgjatjes mesatare e ndërprerjeve për klientët, të cilët kanë ndërprerje gjatë një periudhe kohore (vit, tremujor, gjashtëmujor). Ai llogaritet si raport i shumës të të gjitha kohëzgjatjeve të ndërprerjeve të konsumatorëve të ndërprerë me numrin total të klientëve, sipas formulës së mëposhtme:

$$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K D_i \times N_i}{N_T}$$

ku: N_i = numri i klientëve të përfshirë në ndërprerjen “i”

N_T = është numri total i klientëve të furnizuar gjatë atij viti

D_i = kohëzgjatja e ndërprerjes “i”

K = numri total i ndërprerjeve

Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve (SAIFI) nënkupton numrin mesatar të ndërprerjeve për klient gjatë një periudhe të caktuar (vit, gjashtëmujor, tremujor) dhe jep informacion për frekuencën mesatare të ndërprerjeve për klient në një zonë të paracaktuar. Ai llogaritet si raport i numrit total të ndërprerjeve të klientit pjesëtuar me numrin total të klientëve të shërbyer:

$$SAIFI = \frac{\sum_{i=1}^k N_i}{N_T}$$

ku: N_i = numri total i klientëve të përfshirë në ndërprerjen “i”

N_T = numri total i klientëve të furnizuar gjatë atij viti

k = numri total i ndërprerjeve

Koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike pas një defekti në sistemin e shpërndarjes nënkupton llogaritjen e kohës së nevojshme për rikthimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike pas një defekti të paplanifikuar. Ajo llogaritet si përqindja e klientëve të cilëve u është rikthyer shërbimi brenda një kohe të përcaktuar pas defektit të paplanifikuar. Koha e nevojshme llogaritet në mënyrë të veçantë për klientët e lidhur në tensionin e mesëm (35 kV, 20 kV, 10 kV dhe 6



kV) dhe ata të lidhur në tensionin e ulët (0.4 kV). Gjithashtu, ajo llogaritet veças për zonat urbane dhe ato rurale.

Koha e nevojshme për të rilidhur klientëve të cilëve u është ndërprerë energjia elektrike për shkak të detyrimeve të papaguara nënkupton llogaritjen e kohës mesatare që nevojitet nga OSSH-ja për të rilidhur klientin pas njoftimit të furnizuesit për ta rilidhur atë.

Koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit nënkupton kohën e nevojshme, të matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes së kërkesës së klientit, për kontrollin e sistemit të matjes, nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe datës së vënies në dispozicion të dokumentacionit përkatës me rezultatet e verifikimit.

Cilësia e tensionit (VQ) nënkupton matjen e devijimit të tensionit mbi ose nën vlerën nominale të pritshme për tensionin e rrjetit, sipas përcaktimeve të Kodit të Shpërndarjes. Ajo matet veças për çdo tension nominal dhe për zonat urbane dhe ato rurale.

Çdo përkufizim ose term tjetër i përdorur në këtë rregullore ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

PJESA II TREGUESIT E CILËSISË DHE PERFORMANCËS

Neni 5

Treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit, të cilët duhet të llogariten nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të raportohen në ERE janë si më poshtë:

- a) Energjia e pafurnizuar (ENS);
- b) Koha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e shpërndarjes;
- c) Përqindja e klientëve me lexim aktual të matësve;
- d) Zgjidhja e ankesave lidhur me cilësinë e tensionit;
- e) Koha e nevojshme për t'u përgjigjur ndaj ankesave të klientëve lidhur me matjen;

f) Koha e nevojshme për t'u përgjigjur ndaj kërkesave për lidhje të reja;

g) Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI);

h) Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve (SAIFI);

i) Koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit pas një defekti në sistemin e shpërndarjes;

j) Koha e nevojshme për rilidhjen e klientëve të ndërprerë për arsye të mospagesës;

k) Koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit;

l) Cilësia e Tensionit (VQ).

Neni 6

Raportimi i treguesve të matjes së cilësisë së shërbimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

6.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka përgjegjësinë të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme për llogaritjen e treguesve të matjes së cilësisë së shërbimit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Të dhënat duhet të llogariten mbi baza trimujore dhe në mënyrë progresive gjatë vitit kalendarik dhe treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit duhet t'i raportohen ERE-s jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit. Për shembull, brenda datës 30 janar të çdo viti duhet të raportohen të dhënat vjetore në progresiv për vitin paraardhës (nga muaji janar në dhjetor).

6.2 Të dhënat e llogaritura të treguesve të matjes së cilësisë së shërbimit për tremujorin e dytë deri në atë të katërt, krahas të dhënave të secilit tremujor, duhet të përmbajnë dhe ato progresive, ku përfshihen të dhënat e vitit aktual.

6.3 Në funksion të krijimit të një baze të dhënash për vlerësimin e treguesve të matjes së cilësisë së shërbimit, OSSH-ja duhet të ofrojë të dhëna për treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit sipas nenit 5, për vitet kalendarike 2011 deri 2017, jo më vonë se 90 ditë kalendarike pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Në rast se të dhënat për një ose më shumë nga treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, nuk janë të mundur të vihen në dispozicion, OSSH-ja do të informojë ERE-n për këtë fakt.

6.4 Raportimi tremujor do të kërkohet për çdo tremujor nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.



Neni 7

Kriteret standarde të performancës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes

7.1 Në tabelën 1 të kësaj rregulloreje ndodhen kriteret standarde të performancës për OSSH-në që kanë lidhje me treguesit e përcaktuar në nenin 5 të rregullores. Nivelet e pritshme të performancës do të vihen në zbatim brenda datës 31 dhjetor 2018, duke u rivlerësuar në funksion të performancës së ushtruar gjatë kësaj periudhe tranzitore dhe gjendjes së sektorit të energjisë elektrike.

7.2 OSSH-ja nuk do të jetë subjekt i kërkesës për kompensim nga ana e klientëve fundorë, lidhur me mospërmbushjen e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përpara datës 31 dhjetor 2018.

7.3 OSSH-ja do të propozojë në ERE nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, jo më vonë se data 31 shtator 2018.

7.4 Në vitin 2019, ERE do të rishqyrtojë performancën e ushtruar gjatë viteve 2017-2018, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës.

Neni 8

Monitorimi dhe mbikëqyrja

8.1 ERE në zbatim të autoritetit dhe përgjegjësisë të atribuara nga ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, do të sigurojë monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.

8.2 Të licencuarit, klientët dhe të gjithë personat përgjegjës, të cilët me anë të veprimeve apo mosveprimeve të tyre do të cenojnë kriteret standarde të performancës, të miratuara në këtë rregullore, do të jenë përgjegjës sipas përcaktimeve të ligjit për “Sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 9

Kompensimi i furnizuesit

9.1 Në të gjitha rastet e ndërprerjeve, pavarësisht aplikimit të të drejtave të furnizuesit të përcaktuara në “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i paguajë furnizuesit penaltetet automatike të përlogaritura në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje.

9.2 OSHEE është përgjegjës për dëmet që mund t'i shkaktohen furnizuesit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e përcaktuara në aktet në fuqi, vetëm në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të saj. Përcaktimi i dëmit efektiv të shkakuar furnizuesit bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.

9.3 Në të gjitha rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara, me përjashtim të ndërprerjeve të shkaktuara ose rezultatit të ekzistencës së forcës madhore, energjia e cila nominohet nga furnizuesi, por nuk shpërndahet nga OSSH-ja për shkak të ndërprerjes, do të kompensohet nga OSSH-ja si më poshtë vijon:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i paguajë furnizuesit diferencën pozitive ndërmjet çmimit të kontratës/kontratave (në varësi të kohëzgjatjes të ndërprerjes që afekton secilën kontratë furnizimi në mënyrë individuale) dhe çmimit të disbalancave pozitive të aplikuara nga OST-ja.

Neni 10

Kompensimi i klientëve fundorë

10.1 Bazuar në përcaktimet e “Marrëveshjes për sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit”, të miratuar nga bordi i ERE-s, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, OSSH-ja do të kompensojë furnizuesin dhe ky i fundit do të jetë përgjegjës për kompensimin e klientëve fundorë, të cilët kanë një kontratë për furnizimin me energji elektrike me furnizuesin.

10.2 Duke filluar nga data 1 janar 2019, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, furnizuesi është i detyruar t'i japë një kompensim klientit fundor, me kërkesën e këtij të fundit, bazuar në përcaktimet e kësaj rregulloreje lidhur me vlerën e kompensimit.

10.3 Pas paraqitjes së kërkesës për kompensim nga ana e klientit dhe verifikimit të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, sipas afateve të përcaktuara në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve,



në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, furnizuesi e kompenson klientin në faturën pasardhëse të energjisë elektrike.

10.4 Në faturën e dërguar nga furnizuesi, vlera e kompensimit duhet të jetë e përcaktuar nën emërtimin “Kompensim i klientit për mosrespektim të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të miratuara nga ERE”. Gjithashtu, në faturën e energjisë elektrike duhet të përcaktohet së “Përfitimi i kompensimit nuk përjashton mundësinë e klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmshpërblimin e mundshëm për dëmin efektiv të shkaktuar”.

Neni 11

Mospërbushja e detyrimeve

11.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rast të paaftësisë për të përmbushur detyrimet sipas këtyre rregullave, për shkak të një ngjarje të shkaktuar nga forca madhore, duhet të njoftojë ERE-n dhe të gjitha palët e ndikuara, duke detajuar arsyet për paaftësinë e përmbushjes së detyrimeve dhe kohëzgjatjen e pritshme të kësaj paaftësie.

11.2 Gjatë periudhës së ushtrimit të forcës madhore, detyrimet e OSSH-së për përmbushjen e kriterëve standarde të performancës do të pezullohen.

11.3 Në rast se ndonjë nga palët e ndikuara prej mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore vlerëson se deklarimi i forcës madhore është i paarsyeshëm, mund ta referojë

çështjen në ERE për rishikim dhe vendimi i ERE-s do të jetë final.

11.4 Në rast se ERE përcakton se arsyet e mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore nuk ishin për shkak të forcës madhore, atëherë detyrimet e OSSH-së nuk do të konsiderohen si të pezulluara për periudhën e pretenduar.

PJESA III

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që do të lindin si rezultat i moszbatimit të këtyre rregullave, do të trajtohen nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Neni 13

Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave

Kjo rregullore është objekt rishikimi ose ndryshimi me vendim të bordit të ERE-s.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tabela 1 — Kriteret standarde të performancës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes

Treguesit	Niveli i pritshëm i performancës
a) Energjia e pafurnizuar (ENS)	
b) Periudha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e shpërndarjes	
c) Përqindja e konsumatorëve me matës aktual	
d) Zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit	
e) Koha e nevojshme për ankesat e konsumatorit që ka lidhje me matjen	
f) Koha e nevojshme për kërkesat për lidhje të reja	
g) Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare (SAIDI)	
h) Indeksi i frekuencës së ndërprerjeve mesatare (SAIFI)	
i) Koha e nevojshme për riparimin e shërbimit pas një defekti në sistemin e shpërndarjes	
j) Koha e nevojshme për të rilidhur konsumatorët të cilëve u është ndërprerë energjia për shkak të mospagesës	
k) Koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit	
l) Cilësia e tensionit (VQ)	

**VENDIM****Nr. 182, datë 10.11.2017****MBI MIRATIMIN E “METODOLOGJISË
SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “b”, nenit 21 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”,

konstatoi se:

- Me konsulencën e USAID-it u hartua drafti i metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Me vendimin nr. 156, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- ERE, me shkresën nr. 650 prot., datë 4.10.2017, ka njoftuar të gjitha palët e interesuara, si: OSHEE sh.a.; MIE; Autoritetin e Konkurrencës; Avokatin e Popullit; Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve; Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar; Shoqatën e Konsumatorit Shqiptar; Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë; Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfindustria; AAES; AREA; FIAA; ACERC dhe Shoqatën e Prodhuesve të vegjël të Energjisë Elektrike) dhe u ka kërkuar atyre që brenda datës 12.10.2017 të shprehin komentet e tyre mbi draftin, tashmë të publikuar në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 100/48 prot., datë 2.10.2017, ERE, nëpërmjet botimit të njoftimit në shtypin e shkruar, ka ftuar të shprehin

opinionet dhe komentet e tyre me shkrim gjithë personat, shoqatat dhe institucionet që mendohet se kanë interes për këtë vendimarrje brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.

- Në përfundim të afatit nuk rezultoi asnjë koment mbi këtë metodologji.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrir Ahmeti**

**METODOLOGJIA
E LLOGARITJES SË TARIFAVE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE****Neni 1
Baza ligjore**

Kjo metodologji hartohet në zbatim të neneve 7, 19, 20, 21, 22, 35, 45, 46, 68, 69, 70, 72, 75 dhe 76 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenet 21 dhe 22 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, si dhe akte të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.



Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave, duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

Neni 3 Objekti

Kjo metodologji ka për objekt përcaktimin e tarifave të aksesit dhe përdorimit të sistemit të shpërndarjes në zbatim të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 4 Përkufizime

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim si ai i përkthyer në nenin 3 e në vazhdim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor të miratuar nga ERE. Termat e tjerë të përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “Faktori i axhustimit vjetor”, një përqindje e barabartë me faktorin e inflacionit minus faktorin e përmirësimit të eficiencës.

2. “Tarifa mesatare e shpërndarjes”, e ardhura mesatare për kwh për një periudhë 12-mujore, e llogaritur si e ardhura totale nga pagesat që lidhen me kapacitetin, pagesat që lidhen me energjinë dhe pagesat mujore fikse, pjesëtuar me kwh total të livruara nga sistemi i shpërndarjes te klientët fundorë.

3. “Tarifa mesatare tavan e shpërndarjes”, niveli maksimal i lejueshëm i tarifës mesatare të shpërndarjes për një periudhë specifike 12-mujore.

4. “Tarifa bazë e shpërndarjes”, vlera e tarifave të shërbimit të shpërndarjes e përcaktuar në përputhje me kostot në vitin bazë.

5. “Viti bazë”, viti i parë i periudhës rregullatore.

6. “Viti i testimit”, një periudhë 12-mujore përpara periudhës rregullatore, e cila përdoret si bazë e përcaktimit të të ardhurave të kërkuara për vitin bazë për operatorin e sistemit të shpërndarjes.

7. “Tarifat e diferencuara”, tarifat për shërbimet e përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes që përfshijnë pagesat që lidhen me pagesat mujore fikse dhe pagesat për kapacitet dhe energji për klientët sipas niveleve të tensionit.

8. Faktori i përmirësimit të eficiencës (faktori X), përqindja vjetore e reduktimit në koston e shërbimit të shpërndarjes që rezulton nga përmirësimet në eficiencën e operimit të rrjetit dhe përmirësimet në teknologji.

9. “Rregullimi ‘Cap’”, përdorimi i periudhave të rregullimit në të cilat të ardhurat apo çmimi maksimal i të licencuarit rregullohet gjatë këtyre periudhave rregullatore.

10. “Baza e rregulluar e aseteve (RAB)”, vlera e aseteve fikse siç përcaktohet në nenin 8 të kësaj metodologjie.

11. “Periudha rregullatore”, një periudhë disaveqare në të cilën çmimet apo kërkesa për të ardhura lejohen të ndryshojnë me normë/nivele të caktuara.

12. “Sistemi i shpërndarjes”, sistemi i shpërndarjes është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

13. “Klienti” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

14. “Klientë fundorë” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

15. “Enti Rregullator i Energjisë” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

16. “Humbjet në rrjet”, diferenca mes sasisë së energjisë elektrike të livruar në rrjetin e energjisë elektrike dhe sasisë së energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti i energjisë elektrike gjatë periudhës kohore respektive.

17. “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ose (OSSH)” është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën.



18. “Përdoruesit e sistemit” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

19. “Furnizuesi i Shërbimit Universal ose (FSHU)” është furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, i cili furnizon vetëm klientët fundorë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Neni 5

Rregullat e përgjithshme dhe parimet bazë

1. Kjo metodologji është hartuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të akteve të tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Mospërputhja me secilën pjesë të kësaj metodologjie mund të çojë në refuzim nga ana e ERE-s të aplikimit për tarifë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike.

3. Rregullimi i *Price Cap* aplikohet për të ardhurat mesatare të lejuara të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Rregulatori aprovon tarifën mesatare të shpërndarjes. Nëse tarifa mesatare tavan e shpërndarjes për çdo nivel tensioni e përcaktuar në bazë të të dhënave historike për një nga vitet në ciklin e vlerësimit të tarifave e tejkalon tavanin e tarifës mesatare të lejuar të shpërndarjes, të vendosur nga ERE-s për çdo nivel tensioni, OSSH-ja duhet të ulë tarifën mesatare të shpërndarjes në vitin vijues për atë nivel tensioni, në mënyrë që klientët dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes në një nivel të caktuar tensioni të marrin një rimbursim të shumës së të ardhurave të tepërta të mbledhura (shuma e mbishlyerjes).

4. Gjithë burimet e të ardhurave të OSSH-së të përcaktuara në këtë metodologji tarifash paguhen nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

5. Tarifa e shpërndarjes duhet të:

a) Shlyejë kostot e pronësisë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kablllove, nënstacioneve të transformatorëve dhe ndërtesave që lidhen me to.

b) Tarifa për operatorin e sistemit të shpërndarjes duhet të reflektojë koston aktuale të

shërbimit për çdo grup konsumatorësh sipas niveleve të tensionit.

c) Tarifa e shpërndarjes duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që të mos lejojë ndërsubvencionimin ndërmjet grupeve të klientëve.

d) Klientëve fundorë do t’u shpërndahen kostot e humbjeve të energjisë elektrike në varësi të nivelit të tensionit ku ata furnizohen. Energjia elektrike e përdorur nga klientët që nuk maten te pika e tyre tregtare e livrimit të shërbimit do të rregullohet në mënyrë që të mbulohen humbjet e energjisë nga pika tregtare e livrimit te pika e matjes.

e) Kostoja e blerjes së energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes (sipas objektivit të përcaktuar nga ERE sipas kësaj metodologjie) përfshihet në tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit.

6. Metoda “RPI-X” do të përdoret për t’i dhënë OSSH-së nxitje për reduktimin e kostove të veta gjatë ciklit të vlerësimit të tarifave.

7. Periudha rregullatore; kohëzgjatja e ciklit të shqyrtimit të tarifave të shpërndarjes është tre vjet. Nëse tarifat mesatare tavan të shpërndarjes sipas niveleve të tensionit për ciklin pasues të tarifës së shqyrtuar nuk janë aprovuar ende para përfundimit të periudhës trevjeçare, rregulatori mund të miratojë një vendim për zgjatjen e ciklit të shqyrtimit të tarifave deri në katër vjet.

8. Cikli i shqyrtimit të tarifës së shpërndarjes dhe cikli i shqyrtimit të tarifës së transmetimit duhet të fillojnë në të njëjtën ditë të vitit.

9. Financimi afatgjatë i borxhit përdoret për të financuar shpenzimet e reja kapitale për aq sa është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit.

10. Tarifat duhet të reflektojnë kostot aktuale të shërbimit për çdo përdorues të sistemit të shpërndarjes dhe duhet të japin sinjale për përdorimin eficient të rrjetit të shpërndarjes.

11. Kostot e përfshira në tarifë duhet të jenë transparente për palët e interesuara.

12. Tarifa duhet t’i lejojë OSSH-së mundësinë e një kthimi të arsyeshëm mbi bazën e rregulluar të aseteve.

13. Tarifat duhet të jenë relativisht të qëndrueshme në kohë.



14. Periudha e parë rregullatore sipas kësaj metodologjie fillon në 1 janar 2018.

15. ERE do të miratojë formatet e tabelave për aplikimet për tarifa. OSSH-ja do të përdorë formatet e tabelave të miratuara nga ERE kur përgatit aplikimin për tarifë për një periudhë rregullimi. Format i tabelave mund të modifikohet për sa kohë që informacioni është organizuar në mënyrë të ngjashme dhe detajimi i informacionit nuk është më i vogël se ai i tabelave standarde të miratuara. Tabelat do të tregojnë rezultatet e vitit të testimit, rregullimet e bëra për vitin e testimit dhe për vitin bazë, duke përfshirë, por jo vetëm, shpenzimet e kompanisë, shpenzimet kapitale dhe bazën e rregulluar të aseteve për shërbimin e rregulluar.

16. Në përgatitjen e aplikimit për tarifa, OSSH-ja do të përpiqet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë. Rregullatori nuk duhet t'i diskutojë shifrat më të vogla se 100,000 lekë, përveç kur ka një mosmarrëveshje mbi kompensimin ose pagesën për persona të veçantë fizike.

Neni 6

Energjia elektrike dhe bilancet e energjisë elektrike

1. Bilanci i energjisë elektrike të OSSH-së për vitin bazë do të përgatitet nëpërmjet përlllogaritjes së shumës totale të energjisë në GWh të livruar në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit bazë. Ky total është i barabartë me energjinë e marrë nga sistemi i transmetimit, burimet prodhuese të lidhura në sistemin e shpërndarjes. Energjia totale e marrë duhet të ndahet në:

- a) energji elektrike e livruar te FSHU;
- b) energji elektrike e livruar te klientët fundorë;
- c) humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes;
- d) energji elektrike e konsumuar nga OSSH-ja për nevoja vetjake.

2. Bilanci i pikut koincidues të fluksit të ngarkesës së OSSH-së do të përlllogaritet duke pasqyruar fuqinë totale në MW të marrë nga sistemi i shpërndarjes në orën e pikut. Ky total është i barabartë me fuqinë e marrë nga sistemi i transmetimit plus fuqinë e marrë nga centralet e gjenerimit të lidhur me sistemin e shpërndarjes. Energjia totale e marrë duhet ndarë në:

- a) energjia e livruar te FSHU;
- b) energjia livruar te klientët fundorë;
- c) humbjet në sistemin e shpërndarjes;
- d) energji elektrike e konsumuar nga OSSH-ja për nevoja vetjake.

3. Shoqëria e shpërndarjes do të llogarisë shumën totale të të gjithë ngarkesave jokoinkiduese për grupet e klientëve sipas nivelit të tensionit.

4. Për secilin nga dhjetë vitet e fundit, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes duhen treguar si një përqindje e energjisë së marrë nga sistemi i shpërndarjes.

Neni 7

Kërkesa për të ardhura për vitin bazë

1. Shpenzimet e vitit të testimit për përcaktimin e kostove për vitin bazë do të bazohet në informacionin kontabël në përputhje me sistemin uniform të llogarive të aprovuara nga ERE ose Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Viti i testimit do të jetë një periudhë historike 12-mujore përfaqësuese e kostove operative të shoqërisë. ERE, gjatë shqyrtimit të aplikimit për tarifë, ka të drejtë të kontrakttojë ekspertë të pavarur për të kryer një kontroll të informacionit kontabël të vitit testues të OSSH-së.

2. OSSH-ja mund të propozojë ndryshime të rezultateve të shpenzimeve të vitit të testimit për përcaktimin e tarifave për vitin bazë të periudhës së ardhshme rregullatore. Çdo ndryshim i tillë duhet të jetë i njohur (një artikull i veçantë) dhe i matshëm nga ana sasiore. Fondet e planifikuara për mbulimin e kostove të ngjarjeve të pasigurta apo të paparashikuara, nuk do të miratohen nga ERE.

ERE do të marrë në konsideratë rregullime në vitin e testimit, të tilla si:

- a) ndryshimi i kërkesës;
- b) inflacioni;
- c) ndryshime në çmimin e kontraktuar;
- d) ndryshime në taksa dhe sigurime;
- e) numri i klientëve të shërbyer;
- f) rritje e nivelit të bazës së rregulluar të aseteve;
- g) kostoja e kapitalit;
- h) niveli i shpenzimit të amortizimit;
- i) faktori i eficiencës;
- j) të ardhura të tjera.

3. OSSH-ja duhet të paraqesë argumente për çdo rregullim/korrigjim të parashikuar të



rezultateve të vitit të testimit. Rregullimet duhet të specifikohen në tabelat e paraqitura nga OSSH-ja në aplikimin për tarifë, si dhe dëshmi me shkrim duke dhënë prova për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi.

4. Për aktivitetin e rregulluar sipas metodës *Price Cap*, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të paraqesë faktorët e rregullimit të vlerësuar/parashikuar, të cilët do të përfshihen në çdo vit të periudhës së rregullimit. Këta faktorë do të përfshijnë:

- bazën mesatare vjetore kumulative të aseteve të rregulluara për periudhën rregullatore;
- humbjet totale të energjisë;
- faktorin vjetor të inflacionit;
- faktorin vjetor të përmirësimit të eficiencës.

5. Kërkesat për të ardhura për vitin bazë do të llogariten si vijon:

$$RR = C + (RAB * WACC),$$

ku:

RR - janë kërkesat vjetore për të ardhura

C - kostoja e lejuar vjetore e operimit për aktivitetin e licencuar

RAB - baza e Rregulluar e Aseteve

WACC - mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1,$$

ku:

ES- objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB

T - norma e taksës së korporatës

ARoE - norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas taksës

DS - objektivi për raportin e borxhit në RAB

CoD - kostoja e borxhit

6. Pagesat në lidhje me qiramarrjen (për shembull, marrja me qira e automjeteve) mund të përfshihet në shpenzimet operative.

7. Kostot operative të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që përfshihen në kërkesën për të ardhura për shërbimet e licencuara do të specifikohen në mënyrë analitike në aplikimin për tarifë.

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të paraqesë për miratim nga ERE nivelin mesatar të humbjeve të energjisë elektrike për çdo nivel tensioni në rrjetin e shpërndarjes. Kostoja e blerjes së energjisë/kapacitetit për të mbuluar humbjet e energjisë do të jetë një shpenzim

operativ i OSSH-së, sipas niveleve të lejuara nga ERE, të cilat do t'i alokohen shërbimit për përdorimin e rrjetit në nivele të ndryshme të tensionit.

9. Kostoja e humbjeve do të vlerësohet me çmimin blerjes së energjisë elektrike, të caktuar sipas pikës 4, të nenit 5 dhe pikës 2, të nenit 11, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016.

10. Kërkesat për të ardhurat nuk do të përfshijnë pagesat për gjobot dhe penalitetet.

Neni 8

Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve

1. Baza e rregulluar e aseteve për shërbimin e licencuar përfshin asetet materiale dhe jomateriale minus amortizimin e akumuluar plus një pjesë të kapitalit të punës. RAB-ja llogaritet sipas formulës në vijim:

$$RAB = A - CG - D + WC + INV,$$

ku:

RAB - baza e rregulluar e aseteve

A - vlera e njohur e aseteve të përdorura dhe të dobishme në fillim të periudhës rregullatore

CG - vlera e aseteve të përfituara nëpërmjet dhurimit ose të ndërtuara me burime financiare të konsumatorëve të energjisë elektrike

D - amortizimi i akumuluar për periudhën e kaluar të aseteve të përdorura për kryerjen e aktivitetit të licencuar. Amortizimi i investimeve të reja gjatë periudhës rregullatore do të jetë i barabartë me mesataren vjetore kumulative të amortizimit të mesvitit.

WC - kërkesa për kapitalin e punës

INV - vlera mesatare nominale kumulative e investimeve, e parashikuar për mesvitin, të miratuar nga ERE, që do të investohen gjatë periudhës së rregullimit.

2. ERE do të aprovojë RAB-në për vitin bazë. Jo të gjitha asetet e kompanisë së shpërndarjes mund të përfshihen në bazën e rregulluar të aseteve për shërbimin e licencuar. Asetet që nuk e mbështesin shërbimin e licencuar do të përjashtohen nga asetet bazë të rregulluar. Shembuj të aseteve të përjashtuara janë asetet e përdorura për aktivitetet e palicencuara, pajisjet/mjetet e argëtimit.

3. Në bazën e rregulluar të aseteve do të përfshihet vlera e investimeve të miratuara nga ERE në përputhje me rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të



investimeve, të cilat mbështetin shërbimet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. OSSH-ja do të paraqesë në ERE një dëshmi të shkruar mbi ndarjen e programit të propozuar të investimeve për secilin vit të periudhës së rregullimit.

4. ERE do të rishikojë investimet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara/të miratuara çdo fundviti dhe do të korrigjojë tarifat në rast se OSSH-ja dështon në zbatimin e planit të investimeve.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të tregojë amortizimin e akumuluar të llogaritur për të gjitha asetet që përfshihen në bazën e rregulluar të aseteve (RAB) gjatë vitit të fundit të periudhës korrente rregullatore dhe propozon një vlerësim të amortizimit për vitin bazë të periudhës së ardhshme rregullatore.

6. Asetet rregullatore apo asetet për përdorim të ardhshëm janë shpenzimet që nuk kryhen në mënyrë periodike, të cilat do të mbulohen nga OSSH-ja gjatë një periudhe kohe të caktuar.

7. ERE do të zbatojë sistemin fiskal për llogaritjen e amortizimit për qëllime të rregullimit, por mund të vendosë të përdorë norma të tjera amortizimi në raste të veçanta. Amortizimi i aseteve mund të bazohet edhe në një studim të amortizimit të aseteve të paraqitura nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili do të tregojë jetëgjatësinë e aseteve sipas kategorisë bazuar në një studim teknik.

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të paraqesë propozime për amortizimin e aseteve jomateriale dhe aseteve të mbajtura për përdorim të ardhshëm/rregullatore.

9. Vlera e lejuar e kapitalit të punës në bazën e rregulluar të aseteve duhet të bazohet në një studim të fondeve që kërkohen për të mbajtur një nivel të përshtatshëm të materialeve, furnizimeve dhe parave të nevojshme rezervë, për të përmbushur detyrimet korrente dhe për të mbajtur llogaritë minimale. Çdo studim i tillë do të përfshihet në aplikimin për çmim të paraqitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Në mungesë të studimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të paraqesë një vlerësim të masës së lejuar të kapitalit të punës nëpërmjet një evidence me shkrim, duke justifikuar këtë vlerësim. Në mungesë të paraqitjes së studimit, kapitali i punës nuk do të njihet më shumë se 1/12 e shpenzimeve operative.

10. Norma e fitimit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të reflektojë ndonjë aset të përftuar nëpërmjet dhurimit.

11. Për llogaritjen e normës së lejuar të kthimit mbi kapitalit e vet do të përdoret *Capital Asset Pricing Model (CAPM)* ose metodologji të tjera, ku të merren në konsideratë një numër faktorësh, duke përfshirë: 1. krahasime me shoqëri të tjera që kanë risk të njëjtë; 2. tërheqjen e kapitalit; 3. kushtet aktuale financiare dhe ekonomike; 4. koston e kapitalit; 5. riskun e biznesit; 6. politikën financiare dhe strukturën e kapitalit të kompanisë; 7. kompetencën e menaxhimit; dhe 8. historikun financiar të shoqërisë.

12. Për llogaritjen e koston së borxhit në modelin e llogaritjes së WACC-së do të bazohet në normat e interesit për borxhin e papaguar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Normat e interesit të përdorura për përcaktimin e kërkesës për të ardhura mund të jenë ose të mos jenë të njëjta me normat aktuale të interesit të borxhit. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të tregojë që normat e interesit për borxhin janë në përputhje me normat tregtare të interesit për borxhin të pranuar nga kompanitë e tjera me risk të ngjashëm krediti. Çdo borxh i përfshirë në llogaritjen e normës mesatare të interesit të borxhit, që ka një normë interesi më të lartë se niveli aktual i tregut do të rregullohet në zbritje deri në nivelin e tregut.

Neni 9

Shërbimet dhe grupet e klientëve

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të sigurojë shërbimin e përdorimit të rrjetit, matja dhe leximi i matësve, shkëputja dhe rilidhja e matësve, kompensimin e fuqisë reaktive dhe shërbimet për lidhjet e reja.

1.1 Përdorimi i rrjetit. OSSH-ja do të sigurojë akses në rrjet për klientët në rrjetin e shpërndarjes. OSSH-ja do të vendosë për këta konsumatorë një pagesë kapaciteti dhe një pagesë energjie. Pagesa e energjisë për klientët e OSSH-së do të përfshijë humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa pagesa për kapacitet do të alokohet sipas profileve të standardizuara të ngarkesës për çdo grup konsumatori.

1.2 Matja dhe leximi i matësve. OSSH-ja do të operojë dhe do të mirëmbajë të gjitha pajisjet e



matjes dhe do të lexojë matësit, siç kërkohet për klientët e shitjes me pakicë të lidhur në sistemin e shpërndarjes.

1.3 Shërbimi i shkëputjes dhe i rilidhjes së matësve. OSSH-ja, me kërkesë të FSHU-së ose furnizuesve të tjerë apo me vullnetin e saj, shkëput një klient për mospagim ose për shkelje të tjera në përputhje me kushtet e furnizimit. Rilidhja, gjithashtu do të bëhet siç përcaktohet në rregullat e shërbimit të klientit.

1.4 Kompensimi i energjisë reaktive. OSSH-ja do të ngarkojë të gjithë klientët mbi 50 kVA për kompensimin e energjisë reaktive. Llogaritja e pagesave gjatë një muaji, nëse ka, jepen në seksionin 11 në vijim.

1.5 Lidhjet e reja. Pagesa e çdo lidhjeje të re do të përcaktohet për klientët e shitjes me pakicë në përputhje me rregulloren e lidhjeve të reja të miratuar nga ERE.

2. Klientët fundorë, të cilët nuk furnizohen nga FSHU-ja do të faturohen individualisht nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

3. Klientët fundorë të cilët përdorin rrjetin e shpërndarjes do të ndahen në grupe klientësh bazuar në nivelin e tensionit të lidhjes. Disa nëngrupe klientësh mund të krijohen brenda çdo niveli tensioni.

Neni 10

Alokimi i kostove në pagesa të përdorimit të rrjetit që lidhen me energjinë dhe kapacitetin

1. Çdo klient duhet të paguajë një pagesë energjie, në lekë/kwh, bazuar në numrin e kwh të livruar nga sistemi i shpërndarjes te klienti gjatë atij muaji.

2. Klientët të pajisur me matësin e përshtatshëm do të paguajnë gjithashtu një pagesë kapaciteti për shpërndarjen, nëse është e përshtatshme, në lekë/kw/muaj, bazuar në vlerën më të lartë të ngarkesës pik jokoinçidues të klientit gjatë periudhës 12-mujore që mbaron me muajin e faturimit ose në kapacitetin kontraktual të garantuar. Për çdo tejkallim të vlerës së kërkesës pik jokoinçidues mbi kapacitetin e garantuar në kontratë, mund të aplikohet një gjobë.

3. Në një aplikim për tarifë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të parashikojë për çdo grup klientësh tariforë dhe jotariforë (sipas nivelit të tensionit 35/20/10/6/0.4 kV, në

tension të mesëm dhe tension të ulët), informacionin në vijim:

a) Një vlerësim të kapacitetit total të livruar në kw të kërkuar për sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm me energji në çdo grup klientësh.

b) Energjinë totale në kwh që do të tregohet në faturat e klientëve fundorë në çdo muaj të vitit bazë dhe shumën e tyre totale të faturimit.

c) Një parashikim i humbjeve në sistemin e shpërndarjes që u ngarkohen klientëve fundorë në çdo nivel tensioni (kostoja e humbjeve do të përfshihet në pagesat për energji (koston variabël) për secilin grup të klientëve).

4. Kostoja fikse e të ardhurave të kërkuara alokohet për çdo grup të klientëve fundorë në vitin bazë. Tarifa e kapacitetit në lekë për kw për muaj është:

$$P_{\text{kapacitet}} = \text{kostoja fikse e alokuar/L, ku:}$$

L - kapaciteti total i livruar, kw

5. Kostot që lidhen me energjinë në të ardhurat e kërkuara alokohen për çdo grup të klientëve fundorë (në tension të mesëm dhe tension të ulët).

Çmimi i energjisë, në lekë për kwh është:

$$P_{\text{energji}} = \text{kostoja variabël e alokuar/E}$$

E - energjia totale në kwh që do të tregohet në faturat e klientëve fundorë gjatë vitit bazë

6. Kostoja variabël e alokuar për klientët do të përfshijë koston për sigurimin e humbjeve të energjisë, të ndara sipas niveleve të tensionit.

7. Për klientët, matësi i të cilëve mat vetëm konsumin energjisë elektrike aktive në kwh, çmimi për kwh llogaritet në mënyrë që të mbulojë kostot që lidhen me kapacitetin dhe kostot që lidhen me energjinë:

$$P_{\text{mesatare}} = \text{kostoja fikse e alokuar} + \text{kostoja e variabël e alokuar/E,}$$

ku:

E - energjia totale në kwh që do të tregohet në faturat përkatëse e klientëve fundorë gjatë vitit bazë

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të paraqesë në ERE një aplikim për çmime të energjisë pik/jopik në sistemin e tarifave të përdorimit të rrjetit. Në këtë aplikim do të ketë dy vlera të energjisë: i) një që i korrespondon periudhave pik (kur humbjet e rrjetit janë më të larta dhe vlera e energjisë është më e lartë; dhe ii) një që i korrespondon periudhave jopik (kur



humbjet e rrjetit janë më të ulëta dhe vlera e energjisë është më e ulët. Në aspektet e tjera metodologjia e tarifave do të jetë njëlojë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të shpjegojë në aplikimin e tij për tarifa-kostot dhe përfitimet nga zbatimi i strukturës së tarifave pik dhe jopik për përdorimin e rrjetit të shpërndarjes. Metoda pik/jopik kërkon matës më të shtrenjtë që mund të justifikohen vetëm me diferencat e çmimeve pik/jopik për energjinë e gjeneruar dhe të importuar dhe në lidhje me çmimet pik dhe jopik të aplikuara nga FSHU-ja, mund të justifikohet blerja e matësve të kërkuar.

Neni 11

Shërbimet që lidhen me matjen

1. OSSH-ja do t'u ofrojë shërbime të matjes FSHU-së dhe furnizuesve të tjerë.

2. OSSH-ja do të ngarkojë furnizuesit me një pagesë për shërbimin e matjes dhe leximin e matësve për çdo klient që furnizohet me energji nga furnizuesit. Të gjitha kostot që lidhen me instalimin, operimin, mirëmbajtjen, kalibrimin dhe leximin e matësve të shitjes me pakicë dhe shumicë do të përfshihen në kërkesat për të ardhura të alokuara për këtë shërbim, të ndara sipas niveleve të tensionit. Çmimi do të përcaktohet nga pjesëtimi i kërkesës totale për të ardhura për nivelin e veçantë të tensionit me numrin e klientëve të lidhur në atë nivel tensioni.

3. OSSH-ja ngarkon pagesa për ndërprerjen dhe rilidhjen e matësve. Kërkesat për të ardhura për këto shërbime duhet të përfaqësojnë koston mesatare vjetore për sigurimin e këtij shërbimi. Ka një çmim në kohën e rilidhjes që do të përfshijë koston e ndërprerjes së lidhjes, e cila duhet të parapaguhet përpara se të bëhet rilidhja. Të ardhurat e kërkuara të alokuara për ndërprerjen e lidhjes dhe rilidhjen, duhet të përfshijnë shpenzimet që lidhen me punën, transportin, si dhe shpenzime të tjera administrative që lidhen me kryerjen e këtij shërbimi.

Neni 12

Përcaktimi i tarifës mesatare tavan të shërbimit të shpërndarjes

1. Për vitin bazë, tavani i tarifës mesatare të shpërndarjes është i barabartë me tarifën mesatare të shpërndarjes të llogaritur në përputhje me kostot e vitit bazë.

Faqe | 10866

2. Për vitin e dytë të ciklit të rishikimit të tarifës së shpërndarjes (viti 2), çdo komponent i tarifës së përdorimit të rrjetit të shpërndarjes për vitin bazë shumëzohet me faktorin vjetor të rregullim/i korrigjimit:

$$A = (1 + RPI - X),$$

ku:

A - faktori vjetor i rregullim/i korrigjimit

RPI - norma e parashikuar e inflacionit të çmimit të konsumatorit për vitin 2, sipas Bankës së Shqipërisë ose publikimeve të INSTAT-it

X - faktori i përmirësimit të efciencës i vendosur nga ERE

3. ERE do t'i shtojë kësaj formule një faktor Q të përmirësimit të performancës, të bazuar në cilësinë e furnizimit të klientëve fundorë. Këta faktorë të përmirësimit të performancës duhen përcaktuar shumë qartë dhe thjeshtë dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurojë ERE-n që është e aftë të sigurojë të dhënat për cilësinë e furnizimit që nevojiten për të matur me saktësi përmirësimin e performancës.

4. Faktori X do të përfshijë të paktën katër kategori të shpenzimeve: puna direkte dhe indirekte, produktiviteti i punës, prokurimi dhe teknologjia. Teknologjia do të përfshijë implementimin e sistemeve të menaxhimit dhe pakësimin e humbjeve teknike.

5. Për çdo vit pasues të periudhës rregullatore, tarifat e shpërndarjes për vitet e mëparshme do të shumëzohen me një faktor vjetor të rregullimit ashtu si u veprua në vitin e dytë.

Neni 13

Pagesa për energjinë reaktive

1. Kompensimi i energjisë reaktive normalisht është një shërbim ndihmës i siguruar nga gjeneruesit për OST-në dhe, si rrjedhim pagesat për energjinë reaktive janë pjesë e tarifës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dështon vazhdimisht të përmbushë standardet e tensionit të vendosura në interkoneksionit midis rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes, OST-ja mund t'i ngarkojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes penalitete për energjinë reaktive. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të instalojë kapacitete të energjisë reaktive ose reaktorë, sipas nevojës në vend që t'i paguajë penalitete kompanisë së transmetimit.



2. Gjithashtu, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë t'i kërkojë një klienti të rrjetit të shpërndarjes të mbajë një faktor fuqie të caktuar në pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

3. Klientët me kapacitet prej 50 kVA e lart paguajnë një shumë mbi vlerën e energjisë elektrike aktive në varësi të energjisë reaktive të përdorur dhe të çliruar me faktor mesatar mujor të kapacitetit më të vogël se 0.9 gjatë ditës dhe zonës së pikut ditor.

4. Sasia e energjisë reaktive e përdorur, për të cilën paguhet një shumë sipas pikës 3 të këtij neni, është diferenca pozitive midis sasisë së energjisë reaktive të përdorur dhe produktit të sasisë së energjisë elektrike aktive të përdorur me një koeficient korrespondues të faktorit mesatar mujor të fuqisë, sipas formulës:

$$Er_{alwn} = Er_{used} - (Ea_{used} \times (1 - F)),$$

ku:

Er_{alwn} - është sasia e energjisë elektrike reaktive në kV arh që paguhet

Er_{used} - është sasia e energjisë reaktive të konsumuar nga klienti gjatë periudhave të ditës

Ea_{used} - është sasia e energjisë aktive të përdorur nga klienti sipas zonave të ditës, e përcaktuar nëpërmjet leximeve të pajisjeve për matje komerciale të energjisë elektrike aktive, kwh

$F = 0.9$ për konsumin e energjisë reaktive pa pagesë midis vlerave 1 dhe 0.9 të faktorit të fuqisë

5. Klientët sipas pikës 3, të nenit 13, paguajnë një shumë për sasinë e energjisë elektrike reaktive (Er_{alwn}) të përcaktuar sipas pikës 4, të nenit 13, me një çmim për 1 kV arh, të barabartë me [] për qind të çmimit të rregulluar të furnizimit publik për kwh energji elektrike aktive për zonën përkatëse të ditës dhe nivelin përkatës të tensionit.

6. Klientët, sipas pikës 3, të nenit 13, paguajnë një shumë për sasinë e energjisë reaktive të çliruar gjatë orëve të pikut, të përcaktuar sipas leximeve të pajisjeve për matje komerciale, me një çmim për 1 kV arh, të barabartë me çmimin e rregulluar për klientët e furnizuar nga FSHU-ja për 1 kwh energji elektrike aktive në pik për nivelin përkatës të tensionit.

7. Kurdo që klientët sipas pikës 3, të nenit 13, prodhojnë energji elektrike dhe nxehtësi me cikël të kombinuar gjenerimi, ata nuk i paguajnë

Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes një shumë mbi energjinë e çliruar reaktive të prodhuar nëpërmjet ciklit të kombinuar të gjenerimit.

Neni 14

Afatet

Bazuar në këtë metodologji, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të dorëzojë në ERE një kërkesë për aprovimin e tarifave të reja, në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016.

Neni 15

Dispozita përfundimtare

“Metodologjia e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes” u miratua nga bordi i ERE-s, me vendimin nr. 182, datë 10.11.2017.

Metodologjia e miratuar me vendimin nr. 79, datë 26.6.2008, shfuqizohet.

VENDIM

Nr. 183, datë 10.11.2017

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SHA, PËR NJË NDRYSHIM NË “KONTRATËN E SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI/KESH SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË, PËR PERIUDHËN 1.1.2017–31.12.2017”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 62, DATË 11.5.2017

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike;



si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, të funksionimit dhe të procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për ndryshimin e pikës 1, të nenit 9, të “Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017,

konstatoi se:

Në mbështetje të VKM-së 244/2016, me vendimin nr. 62, datë 11.5.2017, ERE ka miratuar “Kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 21380, datë 20.9.2017, ka përcjellë në ERE kërkesën për ndryshimin e pikës 1, të nenit 9 të “Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017.

- MIE me shkresën nr. 5643/9 prot., datë 28.9.2017, shprehet se kërkesa e OSHEE sh.a. për ndryshimin e kontratës aktuale ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a., nuk gjen mbështetje në parashikimet e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- KESH sh.a., me shkresën nr. 4858/1 prot., datë 27.9.2017, shprehet se propozimi i OSHEE sh.a. është i pabazuar dhe në kundërshtim me

VKM-në datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, por edhe nuk përputhet me detyrimet që burojnë nga licenca e KESH-it dhe ajo e OSHEE-së.

- Në nenin 5, pika 3, të VKM-së nr. 244/2016, parashikim i cili është reflektuar në nenin 9, pika 1 të kontratës, përcaktohet se: Në rastet kur shoqëria publike e prodhimit nuk mund të sigurojë sasinë e kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, sipas parashikimeve të vendosura në pikën 3 të këtij neni, ky i fundit ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. FSHU-ja kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë, për sasinë e siguruar në tregun e parregulluar, sipas diferencës ndërmjet çmimit të rregulluar dhe prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimit mesatar të bursës hungareze HUPEX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë elektrike produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse”. Në këto kushte, kërkesa e OSHEE sh.a. për ndryshimin e kontratës aktuale ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a nuk gjen mbështetje në parashikimet e VKM-së së sipërcituar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. mbi ndryshimin e pikës 1, neni 9 të “Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, nga shoqëria e prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

**VENDIM****Nr. 184, datë 10.11.2017****MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË MTC ENERGY SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E ASETVE PRANË
RAIFFEISEN BANK, PËR EFEKT TË
RISTRUKTURIMIT TË KREDISË**

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika “a” dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; të pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi refuzimin e transferimit të aseteve të shoqërisë MTC Energy sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 4.7.2017, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë MTC Energy sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të bankës Raiffeisen Bank sh.a.

Në vijim të vendimmarrjes së sipërcituar, ERE njoftoi shoqërinë MTC Energy sh.p.k., me shkresën nr. 158/1 prot., datë 21.9.2017, për detyrimin e plotësimit të dokumentacionit të munguar brenda 15 ditësh.

Edhe pas kalimit të këtij afati rezulton se subjekti ende nuk ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, në pajtim me nenin 7, pika 1, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”.

Mungesa e dokumentacionin konsiston si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa: “c”, gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve; “P”, efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit; “g”, efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm

të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar.

- Neni 7, pika 3, subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e autoriteti shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë MTC Energy sh.p.k. për transferimin e aseteve pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 185, datë 10.11.2017****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË PRIMA
ENERGY SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të



Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Prima Energy sh.p.k., në aktivitetin e Tregutit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë Prima Energy sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, ghermat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërinë Prima Energy sh.p.k., në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 187, datë 10.11.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAS SHA NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 4, pika 50 dhe nenit 22, pika 2, gherma “b”; 24, pika 2 dhe nenit 50, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, gherma “b”; neneve 5, 11 dhe 12 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë Albga sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria Albga sh.a., me shkresën nr. 62 prot, datë 19.7.2017, ka paraqitur pranë ERE-s aplikimin për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 126, datë 16.8.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë Albga sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, miratoi certifikimin e shoqërisë Albga sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror.

- Me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s ka lënë në fuqi vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albga sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017”, deri më 31.12.2017.

- Me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, bordi i ERE-s miratoi edhe “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Albga sh.a., me shkresat nr. 521/4 prot. të ERE-s, datë 9.10.2017, nr. 139 prot. të ERE-s, datë 21.11.2017 dhe nr. 139/1 prot., datë 7.11.2017, ka përcjellë në ERE plotësim dokumentacioni për aplikimin e tij.

- Aplikimi i shoqërisë Albga sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në



“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d” (pikat “i”, “ii”, “iv”); germa “e”, “Dokumentacioni dhe garancitë financiare”, pikat “i”, “ii”, “v”, “vii”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9, pika 2, germa “b”, pikat “i”, “ii”, “iii”, “v”, “vi”, “vii”, “viii”, “ix”, “x”, “xi”, “xii”, “xiii”, “xiv”, “xvi”.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa “d” (pikat “v”, “vi”).

- Dokumentacionin dhe garancitë financiare, neni 9, pika 1, germa “e”, pikat “iv”, “vi”.

- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9, pika 2, germa “b”, pikat “iv”, “xv”, “xvii”, “xviii”, do të njoftohet subjekti që t’i depozitojë ato brenda afatit të përcaktuar në kushtin e dispozitivit të vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6-mujor, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose për të plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar.

- Lejet dhe autorizimet mjedisore.

- Një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara, ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD.

- Plan biznesi.

- Volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

- Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.

- Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes.

- Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t’u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

2. Shoqëria e licencuar ka detyrimin të respektojë kushtet e parashikuara në licencën për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror që miraton bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 188, datë 10.11.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAS SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 4, pika 50 dhe nenit 22, pika 2, germa “a”; 24, pika 2 dhe nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”; nenit 5; neneve 5, 11 dhe 12 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria Albgaz sh.a., me shkresën nr. 62 prot., datë 19.7.2017 ka paraqitur pranë ERE-s, aplikimin për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 127, datë 16.8.2017, filloi procedurën për licencimin e



shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017 miratoi certifikimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror.

- Me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s ka lënë në fuqi vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për periudhën 5.1.2017–20.9.2017”, deri më 31.12.2017.

- Me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, bordi i ERE-s miratoi edhe “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Albgaz sh.a., me shkresat nr. 521/4 prot. të ERE-s, datë 9.10.2017, nr. 139 prot. të ERE-s, datë 21.11.2017 dhe nr. 139/1 prot., datë 7.11.2017, ka përcjellë në ERE plotësim dokumentacioni për aplikimin e tij.

- Aplikimi i shoqërisë Albgaz sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d” (pikat “i”, “ii”, “iv”); germa “e”, “Dokumentacioni dhe garancitë financiare”, pikat “i”, “ii”, “v”, “vii”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9, pika 2, germa “a”, pikat “i”, “ii”, “v”, “vi”, “vii”, “viii”, “ix”, “x”, “xi”, “xii”, “xiii”, “xiv”, “xv”, “xvi”, “xvii”.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a.2” (pikat “iii”, “xvi”, “xviii”).

- Dokumentacionin ligjor, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 1, germa “d” (pikat “v”, “vi”).

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale, neni 9, pika 1, germa “e” (pikat “iv”, “vi”), do të njoftohet subjekti që t’i depozitojë ato brenda afatit të përcaktuar në kushtin e dispozitivit të vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6-mujor, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar, si më poshtë:

- Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose për plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar.

- Lejet dhe autorizimet mjedisore.

- Një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri), që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave, ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara, ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit, në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD.

- Plan biznesi.

- Volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

- Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.

- Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes.

- Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t’u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

2. Shoqëria e licencuar ka detyrimin të respektojë kushtet e parashikuara në licencën për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror që miraton bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë